

TERMAT E REFERENCËS

Instituti i Studimeve Politike (ISP) kërkon të kontraktojë **një ekspert të jashtëm për shkrimin e një broshure informative mbi integritetin e kandidatëve në zgjedhjet elektorale**, pjesë e projektit “**Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike**”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në partneritet me Institutin e Studimeve Politike (ISP), BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare (QQ), mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike.

Pozicioni / Shërbim	Ekspert për Shkrimin e nje broshure informative
Titulli i Projektit	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
Mbështetur:	Ambasada Britanike në Shqipëri
Lloji i Kontratës :	Kontratë shërbimi
Periudha e kontratës	gusht 2023
Koha e punës	10 ditë

Rreth ISP-së

ISP është organizatë joqeveritare në fushën e studimeve politike në Shqipëri. Fokusi i saj kryesor është monitorimi i proceseve politike të tranzicionit, aktivitetit të institucioneve politike dhe kushtetuese, edukimi publik përmes parimeve të transparencës, pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe njohjes së koncepteve thelbësore për demokraci funksionale.

Prej vitit 2016 Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke monitoruar parlamentin dhe aktivitetin parlamentar. ISP ka kryer monitorimin periodik klasik të parlamentit përmes mbështetjes së FES (2016-2017), përmes mbështetjes nga ambasada e Holandës (2017-2020). ISP ka monitoruar gjendjen e konfliktit të interesit në parlament dhe jetësimin e Kodit të Sjelljes

me mbështetjen e ambasadës së Norvegjisë (2019-2020), aktivitetin parlamentar në periudhën e COVID me mbështetjen e NDI, Dekriminalizimin në politikë dhe në jetën parlamentare 2019-2021 me mbështetjen e ambasadës holandeze dhe tashmë nga 2021-2023 me mbështetjen e NED, mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë 2019-2022 me mbështetjen e CESS, monitorimin e progresit të Shqipërisë në drejtim të integritetit, me fokus parlamentin 2019-2022 me mbështetjen e KAS.

Rreth projektit

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin

Zgjedhor

Qëllimi i shërbimit

Kërkohe bashkëpunimi me një ekspert të jashtëm për hartimin e për shkrimin e një broshure informative mbi integritetin e kandidatëve në zgjedhjet elektorale. Eksperti është përgjegjës për draftimin e raportit, ofron gjetjet dhe rekomandimet, dhe është përgjegjës për promovimin publik të raportit në takime/konsultime, etj, si dhe për përgjegjësi të tjera të poshtëshënuara të detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

Profili i ekspertit:

- Ekspertizë në metodat sasiore dhe cilësore të kërkimit;
- Aftësi të shkëlqyera hulumtuese dhe aftësi për të punuar me literaturë bashkëkohore;
- Aftësi të mira komunikuese dhe shpirt bashkëpunimi në grup;
- Aftësi për të menaxhuar kohën në mënyrë që të respektohet çdo afat i paracaktuar kohor.

Edukim/Eksperiencë Profesionale/Gjuhë të huaja:

- Titulli, MA në shkenca politike, juridike ose media;
- Minimum 3 vjet eksperiencë profesionale në fushat përkatëse;
- Përdorim i shkëlqyer i gjuhës Shqipe dhe Angleze-të shkruar dhe të folur.

Aftësitë individuale

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
3. Të ketë aftësi analitike dhe mendim kritik;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura;

Detyra dhe përgjegjësitë

Konkretisht eksperti:

- a) Analizon gjetjet mbi procesin zgjedhor të zgjedhjeve vendore 2023, mbledh dhe analizon të dhëna për procesin;
- b) Bën analizën të legjislacionit aktual për zgjedhjet vendore
- c) Njeh në mënyrë të hollësishme legjislacionin e zgjedhjeve në Shqipëri dhe atë të Financimit të partive politike;
- d) Bën analizë të praktikave të mira të BE dhe Anglisë
- e) Ofron gjetjet kryesore të raportit dhe rekomandimet kryesore
- f) Merr pjesë në aktivitetet publike të projektit dhe mbron e punën e tij në publik.
- g) Promovon raportin dhe produktet dhe gjetjet e projektit te grupet e synuara.

Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar
2. Punim shkencor të mëparshëm
3. Ofertë Financiare e nënshkruar në LEK (përfshirë TVSH-në)

Kostot dhe Pagesat

Kosto totale për sigurimin e këtij shërbimi për gjithë periudhën parashikohet të jetë 2000 GBP (dy mijë) bruto. Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit pas paraqitjes së materialeve të realizuara nga eksperti për punën e kryer.

Aplikimi duhet të dërgohet në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 04/08/2021 ora 12:00:

- në formë elektronike në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com,
- me postë në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë/ ose dorazi me zarf të mbyllur pranë zyrave të ISP me titullin e projektit sipër "Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike" - Ekspert për shkrim broshure.

Lutemi specifikoni qartë adresën e subjektit, e-mail ose një nr. kontakti.

Instituti i Studimeve Politike